

**URDHËR**  
**Nr. 66, datë 24.1.2025**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 1136, DATË 30.12.2024, “PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1136, datë 30.12.2024, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**Anila Denaj**